

**AKT- THEMELIMI**  
**DHE**  
**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“NEXA” SHPK**

Sot ne daten 03.02.2025, une ortaku themelues:

Manuela Ballshi, atesia Fatmir, e datelindjes 18.05.1988, lindur ne Durres dhe banuese ne Durres , ne adresen: Lagja nr.13, rruga Pavarsia, Plepa, Durres. E pajisur me karte ID me nr 035478113 dhe me nr Personal I85518087N leshuar ne date 28.12.2019.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise” dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”, kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “NEXA” shpk dhe gjithashtu Hartoj Statutin e Shoqerise “NEXA” shpk si me poshte:

**STATUTI**  
**Neni 1**  
**EMERTIMI I SHOQERISE**

Shoqeria do te quhet “NEXA” shpk dhe eshte Person Juridik Shqiptar.  
Veprimtaria e saj rregullohet nga ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise” dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”

**Neni 2**  
**SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres, Plazh ,Lagja nr 13, ZK 8518, Dyqan 18.5m2, Kodi Postar 2008. Ajo mund te krijoje filiale, zyra perfaqsimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:  
Kembim valuator, Rimbushje elektronike, Kancelari, Shitje, sherbime dhe instalime per sisteme informatike dhe pajisje elektronike (Sisteme Survejimi, Sisteme kundra vjedhjes, Sisteme kundra zjarrit, etj.) Shitje dhe riparim per Celulare dhe Kompiuter, Ushtrim i veprimtarise se transferimit

te parave ne emer dhe per llogari te institucionit financiar jo banke dhe ndermjetesimi per arketimin e faturave te sherbimeve utilitare, (Fatura te energjise elektrike, Ujesjelles. Gjoha te automjeteve, etj)

#### **Neni 4**

#### **KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali i shoqerise "NEXA" shpk eshte 2.500.000 (dymilione e peseqind mije) Lek.

Ky kapital eshte i ndare ne 1 kuote dhe zoterohet ne masen 100% nga ortaku i saj i vetem Zj. Manuela Ballshi.

#### **Neni 5**

#### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar.

Shoqeria do te kete vulen e vet.

#### **Neni 6**

#### **MENYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- Shitblerjes
- Trashegimnise
- Dhurimit
- Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

#### **Neni 7**

#### **ORGANET E SHOQERISE**

Organet e shoqerise do te jene :

- Asambleja e pergjithshme
- Administratoret

Administrator do te jete Zj. Manuela Ballshi, atesia Fatmir, e datelindjes 18.05.1988, lindur ne Durres dhe banuese ne Durres , ne adresen: Lagja nr.13, rruga Pavarsia, Plepa, Durres. E pajisur me karte ID me nr 035478113 dhe me nr Personal I85518087N leshuar ne date 28.12.2019.



Administratorja zgjidhet per 1 afat 5 vjecar , nga data 3.02.2025-02.02.2030.

#### **Neni 8**

#### **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve te meposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- Ndryshimin e Statutit
- Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, eksperteve kontabel .
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raportin e ecurise se aktivitetit
- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit
- Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- Perfaqsimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga Ligji apo statuti

#### **Neni 9**

#### **MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME. MENYRA E THIRRJES**

Mbledhja e asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtzakonshme.

Asambleja e pergjithshme thirret nga Administratori apo ortaket e percaktuar sipas nenit 84 te Ligjit.

Asambleja e Pergjithshme thirret nga administrator te pakten 1 here ne vit, per miratimin e llogarive te shoqerise dhe pasqyrave financiare, por mbledhje te tjera mund te thirren gjate vitit per ceshtje nga me te ndryshmet.

Mbledhja e Asamblese se pergjithshme thirret nepermjet nje shkrese derguar cdo ortaku me poste te zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet te kryhet te pakten 7 dite perpara dates se caktuar per mbledhjen.

Kur Asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikave te mesiperme , ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithë ortaket jane dakort per te marre vendime, pavaresisht parregullsise ne menyren e thirrjes se mbledhjes.

#### **Neni 10**

#### **VOTAT E ORTAKEVE**

Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuota, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqesuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rast se është





person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor ose të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do t'i komunikohet kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhjeje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

#### **Neni 11**

##### **VOTIMI ME PROKURE**

Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas formës së përcaktuar nga ligji.

Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopjoje të noterizuar apo i miratuar nga administratorët, depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda të territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftim për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohen jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes, ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit i jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

#### **Neni 12**

##### **EMERIMI I ADMINISTRATOREVE**

Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose disa persona fizik si administrator të shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe 95 të ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme, i cili nëse miratohet sjell emërimin e personit të propozuar si administrator.

Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të ligjit.

#### **Neni 13**

##### **KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme.

Ndryshimet e Statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhezimet e saj nuk do të shfuqëzojnë



aktet e mëparshme të administratorëve të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhezimi nuk do të ishte dhënë.

Administratorët mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë administratorë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhen në përputhje me kushtet që mund të vendosin administratorët dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratorët nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

#### **Neni 14**

#### **SKUALIFIKIMI DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATOREVE**

Detyra e administratorit përfundon në rast se:

- a) Personi nuk është me administrator sipas parashikimeve të ligjit, përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të ligjit;
- b) Personi ndodhet në gjendje paaftësie pagueuse;
- c) Personi vuan ose mund të vuajë çrregullime mendore;
- d) Personi jep dorëheqje nga detyra duke njoftuar shoqërinë ose;
- e) Ka munguar për me shumë se 6 muaj rradhazi pa lejen e administratorëve të tjerë në mbledhjet e administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të administratorëve vendos ta shkarkoj nga detyra.

#### **Neni 15**

#### **MBLEDHJET E ADMINISTRATOREVE**

Mbledhjet e Administratorëve do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë. Vendimet e mbledhjeve të administratorëve merren me kuorumin e votave që mund të përcaktohet nga administratorët, dhe në rast se ky kuorum nuk është përcaktuar ai do të jetë 2/3.

Asambleja e Përgjithshme cakton njërin prej tyre me detyrën e kryetarit të mbledhjes së Administratorëve, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo mbledhje të administratorëve në të cilat ai është i pranishëm. Në rast se kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda 5 minutave nga ora e caktuar për mbledhjen, administratorët e pranishëm mund të caktojnë njërin prej tyre si kryetar të mbledhjes.

Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast të numrit të barabartë votash, vota e kryetarit do të jetë vendimtare.

Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e administratorëve ose nga një komitet i tyre apo nga persona të cilët veprojnë si administrator pavarsisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e një administratori ose njëri prej tyre ka qenë i skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre ose nuk kishin të drejtë të vototnin, do të konsiderohen të vlefshme njëllë sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si administrator dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë administratorët që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e administratorëve ose nga komiteti i tyre, do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i





efektshëm njëllojë si të ishte miratuar në mbledhjen e administratorëve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

#### **Neni 16**

#### **KUFIZIMET NE VOTIMIN E ADMINISTRATOREVE**

Administratorët, nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e administratorëve, për çështje në të cilin këta anëtarë kanë direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të ligjit, deri në momentin kur në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:

- a) të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshjeje dhe
- b) të autorizojnë 4 anëtarë që të votojnë në lidhje me këtë çështje. Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë QKR.
- c) vota e administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë. Dispozitat e nenit 89 të ligjit do të zbatohen lidhur me përjashtimin e administratorit dhe vendimet e marra në këtë mbledhje.
- d) në rast se në mbledhjen e administratorëve ose të komitetit të tyre diskutohet një çështje e lidhur me të drejten e votes se një administratori, çështja mund t'i drejtohet kryetarit të mbledhjes, përpara perfundimit të saj, dhe vendimi i tij lidhur me çdo administrator të ndryshëm nga ai vete do të jetë perfundimtar dhe i formës së prerë.

#### **Neni 17**

#### **PROCESVERBALET E MBLEDHJES SE ADMINISTRATOREVE**

Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

- 1) Të gjitha takimeve të kryera nga administratorët dhe
- 2) Të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjeve të administratorëve dhe komiteteve të tyre, përfshirë edhe emrat e administratorëve të pranishëm në këtë mbledhje.

## **Neni 18**

### **DIVIDENTET**

Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhet në përpjestim të drejtë me shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve në periudhën për të cilën paguhet dividendi, në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet, brenda 12 vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar të paguajë atë.

Në rast se dividendi kërkohet nga njëri prej ortakëve shoqëria merr vendim për shpërndarje dividendi në raport me kuotat e zotëruara dhe ndal detyrimet tatimore për dividendin sipas ligjit. Ortakët mund ta tërheqin dividendin e shpërndarë ose ta lenë në kompani si të drejtë të realizuar të tyre për ta tërhequr në një moment të mëvonshëm ose për ta riinvestuar atë në shoqëri.

## **Neni 19**

### **KALIMI I FITIMEVE NE KAPITALIN THEMELTAR**

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet të përcaktuara në nenin 14 të ligjit, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividende preferenciale apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

## **Neni 20**

### **PRISHJA DHE LIKUJDIMI**

Në rast likuidimi të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me ligjin dhe vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.





## **Neni 21**

### **NJOFTIMET**

Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohen) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas nenit 3 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortakut. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të përbashkët të tyre në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të ligjit.

Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentat e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve në nenin 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet).

**Emrat dhe nënshkrimet e Ortakëve:**

**Ortakut**

**Manuela Ballshi**

MANUELA BALLSHI

